

BIOGRAFIA PROF. DR. FETAH JAGXHIU

a) Shënimet biografike:

Profesor Fetah Jagxhiu është lindur me 25.12.1937 në Prizren. Shkollën fillore dhe gjimnazin e ka kryer në vendlindje me sukses shembullor.

Në vitin shkollor 1957/58 regjistrohet në Fakultetin AGG në drejtimin e Ndërtimtarisë, në Universitetin e Zagrebit. Studimet i përfundon ndër të parët e gjeneratës së vet në prill të vitit 1963. Si inxhinier i parë i ndërtimtarisë i qytetit të Prizrenit, punësohet në ndërmarrjen shtetërore ndërtimore “Sharr”, ku punon deri në muajin tetor të po atij viti 1963, në tetor të vitit 1963 punësohet si asistent në Shkollën e Lartë Teknikë në Prishtinë, të posa themeluar me tri drejtime: Ndërtimtari, Elektroteknikë dhe Makineri. Në tetor të vitit 1965 themelohet Fakulteti Teknik në Prishtinë si filiale e Fakultetit të Ndërtimtarisë të Universitetit të Beogradit me vetëm një drejtim, atë të Ndërtimtarisë. Prej komisionit Amë të Fakultetit të Ndërtimtarisë u zgjodh, inxh. i dipl. Fetah Jagxhiu, asistent i parë shqiptar i Fakultetit Teknik në Prishtinë ku mbaheshin ligjëratat vetëm në gjuhën Serbokroate. Në tetor të vitit 1965 regjistrohet në studime pasdiplomike posa të themeluara në Universitetin e Zagrebit.

Paralel studimeve pasdiplomike, për shkak të mungesës së kuadrit ishte nevoja të mbante mësimin në shumë lëndë në drejtimin e Ndërtimtarisë, e më vonë me zgjerimin e Fakultetit Teknik edhe me dy drejtime tjera.

Në vitin 1970, ishte ndër të parit në gjeneratën e vet që diplomoi, duke qenë magjistr i parë i shkencave teknike në Kosovë. Po atë vit, sipas ligjit të asaj kohe u zgjodh në thirrjen universitare Docent për dy lëndë: Mekanika dhe Rezistenca e Materialeve.

Në tetor të vitit 1971 u zgjodh dekan i Fakultetit Teknik (dekan i parë shqiptar i Fakultetit Teknik) me pesë drejtime (3 në Prishtinë – Ndërtimtaria, Elektroteknika dhe Makineria dhe 2 drejtime në Mitrovicë – Xehetaria dhe Metalurgjia).

Në vitin 1977 paraqet tezën e Doktoratës në UP, Prishtinë. Në vitin 1978 qëndroi në studime shkencore në Universitetin Politeknik të Krakovit në Republikën e Polonisë. Në vitin 1982 mbron tezën e Doktoratës në Prishtinë.

Në vitin 1982 zgjedhet në thirrjen Prof. inordiner, ndërsa në vitin 1987 zgjedhet në thirrjen Prof. ordiner. Në vitin 1991 nga ana e organeve të dhunshme të asaj kohe së bashku me pedagogët dhe studentët shqiptar largohet nga Universiteti. Në Tetor të po atij viti kyçet në grupin organizativ të pedagogëve të Universitetit të Prishtinës për riorganizimin e mësimin në sistemin e arsimit paralel. Në atë kohë zgjedhet Dekan i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës deri në tetor të vitit 1994. Derisa ishte dekan i FNA në tetor të vitit 1992 në protestat e atij viti burgoset dhe malltretohet nga policia serbosllave e asaj kohe. Në tetor 1994, kryetar i Senatit të Universitetit të Prishtinës deri në vitin 1998. Deri sa ishte dekan i FNA organizon studimet pasdiplomike në vitin 1994/95 në degën e Ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, të cilat studime edhe i udhëheq prej vitit 1995 deri në vitin 2003 (kur është pensionuar).

b) Veprimtaria pedagogjike

Që nga fillimi i karrierës së tij (për shkak të mungesës së kuadrit për mësim në gjuhën shqipe) ka qenë jashtëzakonisht i angazhuar në mbajtjen e mësimit, në shumë lëndë, dhe degë të Fakultetit Teknik.

Edhe si Docent dhe më vonë si Profesor ka qenë shumë vite i angazhuar deri në pensionim në vitin 2003, duke u angazhuar edhe në kohën pas pensionimit deri në vitin 2008, duke dhënë mësimi në lëndë fundamentale të shkencave teknike në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës si dhe në degën e Xehetarisë të Fakulteti Xehetaro-Metalurgjik, në Mitrovicë.

c) Veprimtaria botuese e Prof. dr. Fetah Jagxhiut

Paralel punës si pedagog universitar ka dhënë kontribut të madh në përpilimin e teksteve universitare.

1. “Mekanika I (Statika)” 311 faqe, Prishtinë 1976, recensionin e këtij teksti e kanë bërë: Prof. dr. Ljubodrag Radosavlević, profesor ordinar i Fakultetit të Makinerisë, i Universitetit të Beogradit, inxh. Thanas Gace dhe inxh. Zyhdi Casli, docentët e Universitetit Politeknik të Tiranës. Ky tekst është ribotuar edhe dy herë, në vitin 1985 dhe vitin 1997.

2. “Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga Mekanika I” 353 faqe, Prishtinë 1977, recensionin e këtij teksti kanë bërë docentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, inxh. Thanas Gace dhe inxh. Zyhdi Casli, ky tekst është ribotuar edhe dy herë në vitin 1985 dhe vitin 1997.

3. “Mekanika II (Kinematika)”, 187 faqe Prishtinë 1980. Recensionin e këtij teksti kanë bërë Akademik Tatomir Angjelic, Prof. dr. Lubodrag Radosavlević nga Universiteti i Beogradit si dhe Robert Progridi, Zana Harxhi, Thanas Dimroçi, Kosta Gjika nga Universiteti Politeknik i Tiranës.

4. “Mekanika III (Dinamika)”, 476 faqe Prishtinë 1985. Recensionin e këtij teksti e kanë bërë Akademik Tatomir Angjelić, nga Universiteti i Beogradit dhe Prof. dr. Afrim Vokshi, profesor ordiner i Fakultetit Teknik në Prishtinë.

5. “Rezistenca materialeve pjesa e I”, 355 faqe, Prishtinë 1995. Recensionin e këtij teksti kanë bërë Prof. dr. Afrim Vokshi dhe Prof. dr. Xhevat Perjuci, profesorët ordiner të Fakultetit Teknik në Prishtinë.

6. “Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga Mekanika II (Kinematika)”, 215 faqe, Prishtinë, 1995. Recensionin e këtij teksti kanë bërë Prof. dr. Afrim Vokshi dhe Prof. dr. Ahmet Geca profesorët ordiner të Fakultetit Teknik.

7. ‘Rezistenca e materialeve – pjesa e dytë’, 413 faqe, Prishtinë 1999. Recensionin e këtij teksti kanë bërë Prof. dr. Afrim Vokshi, prof ordiner në FNA dhe Prof. dr. Xhevat Perjuci, profesor ordiner i Fakultetit të Makinerisë në Prishtinë.

8. Si koautori i parë me bashkëpuntorin e tij, Dr.Arton Dautaj “Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga “Rezistenca e matrialeve I, 352 faqe, Prishtinë, 2016. Recenzionin e këtij teksti kanë bërë Prof. dr. Niko Pojani profesor ordinar në Fakultetin e Inxhinerisë së Ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Prof. dr. Misin Misini profesor asistent në FNA në Universitetin “Hasan Prishtina” në Prishtinë.

9. Si koautori parë me bashkëpuntorin e tij, Dr. Arton Dautaj “Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga Rezistenca e matrialeve, pjesa dytë, 420 faqe, Prishtinë, 2017. Recenzionin e këtij teksti kanë bërë Prof. dr. Niko Pojani, profesor ordinar në Fakultetin e Inxhinerisë së

Ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Prof. dr. Misin Misini profesor asistent në FNA në Universitetin “Hasan Prishtina”, në Prishtinë.

Pos këtyre 9 teksteve universitare ai ka botuar edhe dy skripta, si botime interne të Fakultetit Teknik:

1. Koautor i skriptës së botuar në gjuhën serbokroate me ligjëruesin inxh. Vlasta Nikolić nga Beogradi, ”Zbirka rešenih zadataka iz Otpornosti materila” 260 faqe, Prishtinë 1966.
2. Si autor i vetëm F.J “Karakteristikat gjeometrike të figurave dhe i masës së trupit gjeometrik” 130 faqe, Prishtinë 1978. Recenzentët Prof.dr. Ejup Hamiti dhe Mr.Sc. Vukomir Savić.

Për studentët e studimeve pasdiplomike, dega e Ndërtimtarisë në FNA, Prof. dr. Fetah Jagxhiu ka përpiluar dhe botuar këto skripta:

1. “Teoria e elasticitetit” 199 faqe, Prishtinë 1996.
2. “Teoria e plasticitetit” 182 faqe, Prishtinë 1996.
3. “Teoria e zvarritjes” 178 faqe, Prishtinë 1967.
4. “Problemet e reologjisë në konstruksionet e betonit” 216 faqe, Prishtinë, 1997.
5. “Teoria e shufrave murholla” 132 faqe, Prishtinë, 1997.

Për studentët e studimeve pasdiplomike, dega e Makinerisë në Fakultetin e Makinerisë, Prof. dr. Fetah Jagxhiu ka përpiluar edhe botuar një skriptë:

6. “Metodat eksperimentale për caktimin e sforcimeve dhe deformimve” 175, faqe, Prishtinë, 1996.

Për studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës:

1. “Rezistenca e materialeve 1” 185 faqe, Prishtinë, 2014.
2. “Rezistenca e materialeve 2” 63 faqe, Prishtinë 2015.

d) Punimet shkencore të publikuara:

1. “Komponentet e sforcimeve në skajet e trarit të paranderur, Zagreb 1970, punimi i temës së magjistraturës.
2. “Një propozim për prezentimin e saktë të funksionit të zvarritjes dhe të rekalsimit në Buletinin nr.1” të FT, Prishtinë 1980.
3. “Një lloj modeli reologjik për interpretimin e performancës së materialit me karakteristika variable në rrjedhim të kohës, botuar në “Përmbledhjen e punimeve, Buletini nr.1, “ FT. Prishtinë, 1980.
4. “Kuptimi fizik i varësisë algjebrike të Bazantit për korelacionin deformim – sforcim” botuar në “Përmbledhjen e punimeve, Buletini nr.2,” FT Prishtinë, 1980.

5. “Një variantë i teorisë së modifikuar të vjetërsisë për betonin” botuar në “Përmbledhjen e punimeve në Buletini nr.2”. FT Prishtinë, 1980.

Punimet e kumtuara dhe të botuara në Kongreset e Lidhjes së konstruktorëve të Ndërtimtarëve të Jugosllavisë dhe në Kongreset e shoqatës së Mekanikës të ish Jugosllavisë.

Në Kongresin e VII të Lidhjes së Konstruktorëve të ish Jugosllavisë profesori Fetah ka publikuar dy punime shkencore të cilët janë të recenzuar dhe të botuar, titujt e këtyre punimeve janë:

6. “Jedan reoloski model za prezentiranje ponasanja betona” VII KSDGJ, Cavtat- Kroaci, 1983.

7. “Algebarska veza zasnovana na modifikovanoj teoriji starenja”, VII KSDGJ, Cavtat - Kroaci, 1983.

Në kongresin e XVII të Shoqatës për Mekanikë të ish Jugosllavisë Prof, dr. Fetah Jagxhiu është paraqitur me punimin me titull:

8. “Algebarska veza zasnovana na naslednoj teoriji starenja”, XVII Kongres SDMJ, Beçiqi, 1984. Edhe ky punim është recenzuar dhe botuar.

Në “Përmbledhjen e punimeve Buletini nr. 3” punimi me titull:

9. “Kërkesat që duhet të plotësojë funksioni i trashëgimit për betonin”, PPFT. Prishtinë, 1985.

Në vitin 1987, me rastin e vizitës që është bërë me ftesën e Institutit të teorisë së konstruksioneve të Fakultetit Politeknik të Yashi në Rumuni. Prof. dr. Fetah ka kumtu dy punime shkencore (këto kumtime janë mbajtur në gjuhën franceze).

Punimi i publikuar në “Buletinin e punimeve shkencore nr. 4-1” të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës.

10. “Një propozim për përmirësimin e koeficientit të zvarritjes të dhënë me punimin e publikuar në Simpoziumin e mbajtur në Prishtinë në vitin 2005.

11. “Analiza e deformimit në procesin kohëgjatë në varësi nga klasa e soliditeti të betonit te elementet që punojnë në nderjen aksiale”, Prishtinë 2005.

e) Aktivitetet e tjera

Prof. dr. Fetah Jagxhiu si punëtor shkencor i dalluar në ish Jugosllavi e më gjërë, më se dy dekada ka qenë në Kryesinë e Shoqatës Jugosllave të Mekanikës teorike dhe të aplikuar. Shumë herë ka qenë anëtar i jurisë së Kongresit të Shoqatës për ndarjen e shpërblimeve për shkencëtar të rinj. Më se 10 vite ka qenë anëtar i redaksisë së fletushkës shkencore të Shoqatës jugosllave të Mekanikës teorike dhe të aplikuar, fletushkë, e cila botohej në gjuhën angleze.

f) Dekoratat, Lëvdatat, Mirënjohjet, Diplomat dhe Falënderimet

Për punën dhe veprimtarinë e tij, Prof. dr. Fetah Jagxhiu është dekoruar dy herë dhe i janë dhënë shumë, Diploma, Lëvdata, Mirënjohje dhe Falënderime, si:

1. DEKORATË me Kurorë të Argjend për merita të arritura për ngritjen e kuadrit shkencor, me çka është dhënë kontribut në lëmine e zhvillimit ekonomik, shoqëror, shkencor dhe kulturor të vendit, me 10 Shkurt 1970.
2. LAVDATË (me rastin e themelimit të Universitetit të Prishtinës), si mirënjohje për rezultatet e arritura dhe kontributin e tij në ngritjen e mësimit dhe të punës shkencore me 14 Shkurt 1970.
3. LAVDATË (me rastin e kremtimit të dhjetëvjetorit të punës së Fakultetit Teknik) për kontributin në punën e suksesshme dhe zhvillimin e Fakultetit me 24.12.1976.
4. DEKORATË me yll të Argjend për Merita dhe të Arritura të suksesshme me rëndësi për ngritjen e vendit, me 20 tetor 1978.
5. DIPLOMË nga enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (me rastin e 10 vjetorit të UP), 28.03.1980.
6. FLETË FALENDERIMI (me rastin e 20 vjetorit të punës së Fakultetit Teknik), për bashkëpunim të suksesshëm dhe ndihmë të pamohueshme në punën e gjer tanishme, me 7.5.1986.
7. MIRËNJOHJE nga shoqata bëmirese “Nëna Terezë” (në shenjë falënderimi për ndihmën dhe kontributin e dhënë në veprimtarinë humanitare të kësaj Shoqate, ndihma materiale dhe kontributi juaj janë edhe një mbështetje e fuqishme morale, një qëndrese gjithëkombëtare deri në fitore”, me 27.5.1994.
8. MIRËNJOHJE nga Fakulteti i Makinerisë me rastin e 30 vjetorit të themelimit (për punë disa vjeçare, i cili dha kontribut të çmuar për zhvillimin e procesit mësimor, shkencor dhe profesional), me 1 tetor 1997.
9. MIRËNJOHJE nga Universiteti i Prishtinës (me rastin e 30 vjetorit të themelimit të Universitetit të Prishtinës) për kontributin e veçantë në rifillimin e punës dhe udhëheqjen e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Prishtinës, Dekan në periudhën 1991-1994, me 16 Maj 2000.
10. MIRËNJOHJE nga Universiteti i Prishtinës (me rastin e trevjetorit të protestave të mbajtura me 01.10.1997) për kontributin e veçantë në organizimin e protestave, në cilësinë e anëtarit të Këshillit Organizativ të Protestave, me 01.Tetor. 2000.
11. MIRËNJOHJE nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (me rastin e dyzet vjetorit të themelimit dhe punës së Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës) në shenjë të vlerësimit të kontributit të veçantë arsimor dhe studimor - shkencor, 15 nëntor 2005.
12. MIRËNJOHJE nga Universiteti i Prishtinës për merita dhe kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin dhe avancimin e procesit mësimor-shkencor në Universitetin e Prishtinës, me 28 mars 2007.
13. MIRËNJOHJE nga Shoqata për kthimin e Shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta për merita në pengimin e pastrimit Etnik të Kosovës dhe krijimin e kushteve për kthim, Pejë, me 15 maj 2010.
14. MIRËNJOHJE nga Shoqata studentore e studentëve Shqiptar të Universitetit të Zagrebit, Shkëndija, (me rastin e shënimit të 50 vjetorit të themelimit të klubit të studentëve Shqiptar të

Universitetit të Zagrebit, për kontribut të veçantë në themelimin e klubit “Shkëndija”, në aktivitetet studentore, në veprimtari arsimore, edukative profesionale dhe për angazhim dhe kontribut në çështjen kombëtare shqiptare, jepet kjo mirënjohje, si vlerësim dhe respekt për aktin, veprën dhe sakrificën sublime. Për kontribut të veçantë në fushën e arsimit dhe të çështjes kombëtare, Prizren, 23.10.2010.

15. MIRËNJOHJE nga kolegji UBT (me rastin e 10 vjetorit të Universiteti për Biznes dhe Teknologji) për kontributin e dhënë, në zhvillimin cilësor të arsimit universitar në UBT, 02.12.2011.

16. MIRËNJOHJE nga Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës (me rastin e 45 vjetorit të themelimit të Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, për kontributin në avancimin dhe zhvillimin e proceseve mësimore, shkencore dhe udhëheqje të suksesshme të FNA, me 25.11.2010.

17. MIRËNJOHJE nga kolegji UBT (Fakulteti Inxhinieri e Ndërtimit dhe Infrastrukturës) në nderim të performances së dalluar për organizimin dhe ligjërimin në Akademinë Verore UBT, 21.07.2014.

18. MIRËNJOHJE nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – Fakulteti i Edukimit (me rastin e 550-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit- Skënderbeut për kontributin në edukimin e gjeneratave të reja, 7 Qershor 2018.

19. CERTIFICATË nga UBT (Construction Engineering and Infrastructure – 7th International Summer Academy - 2018), for contribution in the Faculty of Civil and Infrastructure), 9-13 July 2018.

20. MIRËNJOHJE nga Fakulteti i Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës (me rastin e 60 vjetorit të themelimit të Fakultetit të Ndërtimtarisë, për kontributin akademik në mësim, shkencë, Nëntor 2021.